VENDIM
Nr. 33/2014

PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË PËRZGJEDHJES SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

(Ndryshuar me vendimin nr. 41/2014 datë 12.6.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", neni 12 i tij, si dhe në zbatim të nenit 19, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet procedura paraprake e përzgjedhjes së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sipas fazave të mëposhtme:

a) Nga shërbimet e Kuvendit të bëhet shpallja dhe bërja publike e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik), për një afat prej 30 ditësh nga publikimi.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit te deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare, për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjesës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t'ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake, e propozuar në pikën I të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t'u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast, që të paktën 28 deputetë t'i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI **Ilir Meta**

Miratuar në datën 22.5.2014